
Shkaqet e krizës globale dhe efektet e saj në Shqipëri

KOKA, M, MAZNIKU, L., BOZDO, A., LUARASI, M.
Universiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit

PËRMBLEDHJE

Në këtë artikull janë trajtuar problemet të cilat kanë të bëjnë me krizën globale aktuale dhe ndikimin e saj në vëndin tonë. Konkretisht janë trajtuar

1. Shkaqet e krizës globale

Dallimi ndërmjet tregut të mallrave dhe tregut financiar Këtu shpjegohet fakti që tregu i mallrave dhe tregu financiar dallojnë nga njëri tjetri. Kështu në tregun financiar krijohet një rreth vicioz shtimesh, pa një pikë maturimi si në tregun e mallrave, pikërisht këtu qëndron thelbi i krizës financiare.

Roli i bankave në krizën financiare. Shpjegohet roli i bankave në krizën aktuale. Në sferën bankare krijohet një rreth vicioz kreditimesh, sa më tepër rritet procesi i kreditimit aq më tepër rritet kërkesa për hua, në këte mënyrë krijohet një portofol huash pa garancinë e mjaftueshme.

Roli i produkteve financiare. Theksohet roli i produkteve të inxhinierisë financiare, të ashtuquajtura derivate financiarë. Për arsye të operimit me derivate financiare, bankat huadhënëse i pakësuan në minimum rezervat e sigurimit për kreditë, sepse i përdorën për të dhënë kredi të reja.

Roli i hipotekave të huase. Përshkruhet kthimi i hipotekave të huasë në tituj obligacionalë, për të siguruar burime kreditimi. Ky fenomen u quajt "Pool creation", dhe ka një rol të rëndësishëm në krizën globale.

Ndryshimi i praktikës së verifikimit të aftësisë paguese të huamarrësve. Në SHBA kredidhënia nuk bazohet më në aftësinë paguese dhe cilësite morale të cdo klienti, por bazohet në analizën e të dhënave statistikore dhe të modeleve ekonometrikë.

Ndikimi i krizës së vëndeve aziatike. Kriza financiare e vitit 1997-të në Azinë Juglindore dhe në Rusi, bëri që të krijoheshin likuiditete të tepërta, me të cilat u Oblenë letra me vlerë nga SHBA. Ky fenomen pati gjithashtu rol në shpërthimin e krizës globale.

2. Pasojat e krizës në vëndin tonë.

Ndikimi i krizës në sistemin financiar dhe bankar. Sistemi ynë bankar dhe financiar nuk u perfshi në krizën globale. Arsyet shpjegohen me faktin se sistemi ynë bankar dhe financiar është më pak i sofistikuar krahasuar me atë të SHBA-se, ku kriza filloi.

Por, ndërkohë treguesit kryesorë të sistemit u prekën nga kjo krizë. Në këtë çështje paraqitet ecuria e treguesve të tillë si;

Inflacioni, Depozitat, Rritje e kërkesës së qeverisë për hua, Tkurrja e kredisë për ekonominë.etj. Gjithashtu jepet ndikimi i krizes ne bujqesine shqi petare.

3. Masat për të zbutur efektin e krizës.

Këtu përshkruhen masat që institucionet shqipëtare kanë marrë për të zbutur efektet e krizës.

Miratimi i nje pakete masash rregullative në fillim të 2008-tës nga Këshilli Mbikëqyres i Bankës së Shqipërisë me synim stabilitetin financiar të vëndit.

Modifikimi i rregullores për administrimin e rrezikut, dhe konkretisht diversifikimin e riskut, nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

Perdorimi i instrumentave monetare dhe fiskale

4. Konkluzione dhe rekomandime .

Fjalë kyç. Derivate financiare, likuiditete,hipoteka te huase, tregues monetare, tregues fiskale.

SUMMARY

In this article are considered problems related with the current global crisis and its impact in our country. Specifically are considered

1. Causes of global crisis

The difference between commodities market and financial markets. Here it's explained the fact that commodities market and financial markets are different from each other. So, a vicious circle of additions is created in the financial markets, without a point of maturity as in the commodities market, precisely here lies the essence of the financial crisis

The role of banks in financial crisis. It is understandable the role of banks in the current crisis. In the banking area is created a vicious circle of bank lending, while lending process increases the loans demands is increased too, so it is created a portfolio of loans without sufficient guarantees.

Role of financial products. It is emphasized the role of financial engineering products, the so-called financial derivatives. Because of operating with financial derivatives, lending banks reduced to a minimum their reserves of security for credits, by using them for giving new loans

The role of the "Pool Creation". Describes the return of mortgage loan in obligation titles, to ensure lending sources. This phenomenon was called "Pool creation", and has an important role in the global crisis.

Changing practice of the verification /certification of the paying ability of the borrowers. In the United States lending is not based anymore to the paying ability and moral qualities of each client, but is based on analysis of statistical data and econometric models.

The impact of Asian countries crisis. Financial crisis of 1997 in the Southeast Asia and in Russia, created excess liquidities, which was bought by U.S. through titles (obligations). This phenomenon influenced to the eruption of global crisis

2. The consequences of crisis in our country.

The impact of financial crisis and the banking system.

Our banking and financial system was not included in the global crisis. Reasons explained by the fact that our banking and financial system is less sophisticated compared to the U.S, where the crisis began. But, while the main indicators of the system were affected by this crisis. In this issue is presented performance of indicators such as; inflation, deposits, increase of government demand for loan, the loan diminishment for economy, etc.

3. Measures to mitigate the effects of the crisis.

Here are described the measures that Albanian institutions have taken to mitigate the effects of the crisis.

Adoption of a package of regulatory measures in the early 2008- from Supervisory Board of Bank of Albania aiming at the country's financial stability.

Modification of regulation on risk management, namely, diversification of risk by the Supervisory Board of Bank of Albania.,

Use of monetary and fiscal instruments. Also are addressed issues of theoretical debate on state intervention in the economy initiated by this crisis, as well as conclusions and recommendations.

Key words. *Financial products, liquid means, loan mortgage, monetary indicators, fiscal instruments.*

HYRJE

Rënia e kompanisë "Lehman and Brothers" shënon fillimin e krizës në SHBA. Kjo filloi si një krizë financiare, për të kaluar shumë shpejt në ekonominë reale dhe për të përfshirë tërë ekonominë botërore.

Kjo krizë është bërë objekt i analizave dhe diskutimit teorik të shumë analistëve të ekonomisë. Për nga përmasat e saj është krahasuar me depresionin e madh të viteve 29-30-te.

Duke marrë shkas nga rëndësia që paraqet analiza e efekteve të kësaj krize në vendin tonë është hartuar ky punim.

Qëllimi bazë i këtij punimi është;

Të evidentojë shkaqet e krizës globale, shkallën dhe treguesit në të cilat kjo krizë ka ndikuar në ekonominë e vendit tonë, dhe masat e marra nga institucionet përkatëse për të zbutur efektet e krizës.

Metodologjia. Punimi është kryer bazuar në analizën e të dhënave të paraqitur nga vjetarët statistikorë të Bankës së Shqipërisë, INSTAT, Ministria e Financave etj, lidhur me efektin e krizës në vëndin tonë, si dhe bazuar në studime të autorëve vëndas dhe të huaj për shkaqet e saj.

1. shkaqet e krizës globale

Kriza aktuale globale filloi si një krizë financiare.

Thelbi i kësaj krize shpjegohet me dallimin ndërmjet tregut të mallrave dhe tregut financiar. Për tregun e mallrave është mekanizmi i çmimeve që rivendos ekuilibrin e tregut. Kërkesa përcaktohet nga aftësia blerëse e konsumatorëve, rritja e kërkesës së konsumatorëve con në rritjen e çmimeve, rritja e çmimeve nxit prodhuesit e mallrave të shtojnë prodhimin, pas kësaj ulet kërkesa e konsumatorëve, për rrjedhojë çmimet e tregut ulen.

Tregu i aktiveve financiarë përbëhet nga produkte që sigurojnë dhe gjenerojnë të ardhura. Për këtë arsye me rritjen e cmimit të tyre nuk ulet, por rritet kërkesa për to, sepse është gjithnjë e më e madhe pritshmëria për shkallën e përfuturit të të ardhurave prej tyre.

Pra, në tregun financiar nuk ka një moment në të cilën për arsye të mekanizmit të çmimeve të rivendosin ekuilibrin, por krijohet një rreth vicioz shtimesh. Këtu qëndron thelbi i krizës financiare. Në vijim do të paraqiten disa faktorë që vepruan në tregun financiar dhe që shkaktuan krizën në SHBA.

1.1. Roli i bankave në krizën financiare.

Përderisa aktorët kryesorë të një sistemi financiar janë bankat, roli i tyre në krizën aktuale globale është tepër i rëndësishëm.

Në SHBA u nxit procesi i *huamarrjes* sepse Banka Qëndrore Amerikane, FED-i për një kohë të gjatë aplikoi një normë të ulët interesi. Klientët kishin mundësi të marrin kredi me kosto të ulët, dhe të blinin pasuri të patundshme dhe letra me vlerë, të cilat nga ana e tyre përseri gjeneronin vlerë.

Në këtë mënyrë rritej cmimi i letrave me vlerë dhe dividendëve, prandaj dhe bankat e nxitën pa kufi procesin e huadhënies, sepse me rritjen e cmimit të aksioneve dhe të dividendëve rriteshin fitimet e menaxherëve dhe të aksionerëve të bankave.

Pra, krijohet kështu një rreth vicioz, sa më tepër rritet procesi i kreditimit aq më tepër rritet kërkesa për hua.

Pasuria e blerë me huanë e dhënë figuronte me një vlerë më të madhe se sa ishte në fakt, pra në bilancet e bankës figuronte me tepër garanci fiktive për kreditin.

Roli i produkteve financiarë

Derivati financiar është një letër me vlerë që rrjedh, që lind nga një letër tjetër me vlerë. Në procesin e huadhënies bankat duhet

të gjenin gjithnjë e më tepër burime. Për këtë qëllim u përdorën dhe u zhvilluan derivatet financiarë.

Kështu fondet e percaktuara me qëllim garantimin e kredise, bankat i shisnin në një institucion tjetër (bankë, kompani financiare, sigurimi etj.). Ky fenomen çoi në dy pasoja;

Fondet e siguruar në këtë mënyrë u përdorën për të dhënë kredi të reja, duke pakësuar në minimum rezervat e sigurimit.

Kredia e dhënë figuron në bilancin e bankës huadhënëse, ndërsa rreziku për mosarkëtimin e saj transferohet në një institucion tjetër.

Përdorimi i hipotekave të huasë.

Gjithnjë me qëllimin që të siguroheshin burime kreditimi, të cilat ishin tej mundësive reale të tregut financiar për të kredituar ekonominë, u përdorën hipotekat me të cilat ishin garantuar huatë ekzistuese. Konkretisht hipotekat e huasë u kthyen në tituj obligacionalë, që shiteshin në tregun e kapitaleve dhe paratë e siguruar përdorëshin për të dhënë kredi të reja.

U krijua një fond me “tituj borxhi” që garantohej me po të njëjtat hua të dhëna. Ky fenomen u quajt “*pool creation*”.

Pra, siç u pa me lart, te tre rastet krijohet mundësinë që përmes rrjetit të derivateve financiarë të siguroheshin gjithnjë e më tepër burime kreditimi, tej mundësive reale, dhe ndërkohe risku i mosshlyerjes të shperndahej në shume hallka.

Në këtë mënyrë u deformua gjithë struktura e mjeteve likuide në ekonominë botërore. Të dhënat në vijim tregojnë për përmasat e deformimit të tregut të likuideve të ekonomisë botërore. Ato janë të datës 5 prill 2009 dhe janë marrë nga punimi i Pano, A “Kriza aktuale financiare kreditore dhe ndikimi i saj në vendin tonë”.

Kështu më 5 prill 2009, në totalin e mjeteve likuide të ekonomisë botërore derivatet financiarë zënë 81 përqind të mjeteve likuide dhe 976 përqind të PBB-së. Pjesën tjetër e zënë “tituj borxhi” dhe “mjete krediti” që gjithashtu kanë një likuiditet të ulët. Ndërsa Cash-i, mjete likuid me aftësi 100 përqind, zë vetëm 1 përqind të mjeteve likuide dhe 7 përqind të PBB-së të ekonomisë botërore.




Fig.1.Mjetet likuide të ekonomisë botërore
Fig.1 The liquidity means of the world economy.




Fig.2.Mjetet likuide te ekonomisë botërore.
Fig.2.The liquidity means of the world economy.

Të dhënat e mësipërme tregojnë se ka një shpërndarje të madhe të rreziqeve, dhe se janë krijuar shume lidhje me burime fiktime. Mjafton huamarrësi i parë të mos shlyejë në kohë, kjo gjë transmetohet në të gjitha hallkat me një shpejtësi shumë të madhe përmes derivateve financiarë.

Ndryshimi i kritereve të aftësisë paguese të huamarrësve .

Gjithashtu pjesa më e madhe e bankave amerikane dobësojnë mënyrën dhe rregullat tradicionale të vlerësimit të procesit të kredidhënies. Kredidhënia nuk bazohet në aftësinë paguese dhe cilësitë morale të çdo klienti, por bazohet në analizën e të dhënave statistikore dhe të modeleve ekonometrikë. Pikërisht mosshlyerja e detyrimeve nga huamarrësit pa aftësi paguese krijoi rrezikun e falimentimeve të shumë bankave në SHBA.

1.5. Ndikimi i krizës së vendeve aziatike.

Kriza financiare e vitit 1997-te në Azinë Juglindore dhe në Rusi, bëri që të krijoheshin likuiditete të tepërta. Në këto vende me fondet e krijuara në USD u blenë obligacione dhe aktive të tjera të SHBA-se. Pra, për SHBA—në shtohet konsumi tej burimeve të brendshme, që çon në defiçit buxhetor dhe të bilancit korrent të pagesave.

Në Maj te vitit 2004-ter Fed-i, rrit normën bazë të interesit deri në 5.25 përqind, por ishte vonë, vështirësitë e likuiditetit për bankat ishin tepër të mëdha.

Me 5 shtator të 2008-tës, kompania “Lehman and Brothers” shpalli falimentin.

Kriza financiare dhe bankare për arsye të natyrës globale te ekonomise botërore dhe të rrjetit të ndërlikuar të derivateve financiare përhapet me shpejtësi në të gjitha tregjet e tjera të botës. Në vijim jepem të dhëna te humbjeve në bursat më të rëndësishme të ekonomise boterore.




Fig.3. Rënia në bursat më Janar-Shkurt 2009
Fig.3. The decrease of the .January-February 2009.




Fig.4. Rënia në bursat për periudhën 2008-2009.
Fig.4. The decrease of the January-February 2009.

2. Pasojat e krizës në vëndin tonë

Ekonomia e vëndit tonë nuk u përfshi nga kriza globale. Kuptohet kriza ka patur ndikim në tregues dhe sfera të jetës ekonomike. Në vijim do të paraqesim ndikimin e krizës në sistemin financiar dhe bankar, dhe gjithashtu në ekonominë reale. 2.1 Ndikimi i krizës në sistemin financiar dhe bankar.

Sistemi ynë bankar dhe financiar i rezistoi krizës financiare. Arsyet shpjegohen me faktin se sistemi ynë bankar dhe financiar është më pak i sofistikuar krahasuar me atë të SHBA-se, ku kriza filloi.

Dallimet e sistemit tonë me atë amerikan qëndrojnë në këto fusha;

Në vëndin tonë nuk është i zhvilluar tregu i instrumenteve financiarë. Aktiviteti i bankave tona është tepër tradicional, përmban pranimin e depozitave të zakonshme bankare dhe dhënien e kredive të thjeshta e të kufizuara.

Nuk ekziston tregu i letrave me vlerë (me përjashtim të bonove të thesarit).

Nuk ekzistojnë derivatet e ndryshme financiarë.

Procedurat e vleresimit të aftësisë për shlyerjen e huasë nga ana e klientit janë gjithashtu tejet tradicionale.

Pavarësisht nga kjo, kriza ka pasur ndikimin e vet në treguesit kryesorë të sistemit financiar dhe bankar dhe konkretisht;

Inflacioni. Në fillim të vitit 2008-të ekonomia gjëndet nën presionin inflacionist, kryesisht si rezultat i goditjeve të ofertës, dhe ka një rritje të inflacionit. Kështu në tremujorin e tretë të vitit 2008-të, inflacioni arrin në 4.2 përqind. Sic shihet nga pamja grafike në fund të 2008-tës shfaqet tendenca në rënie e inflacionit.

Kjo tendence shpjegohet me;

Rënie e cmimeve të lëndëve të para në tregun ndërkombëtar.

Ngadalësimin e ritmeve të kërkës së brendshme për arsye të rënies ekonomike.

Inflacioni mesatar vjetor në tremujorin e parë të vitit 2009-të rezultoi 1.9 përqind, ndërsa në tremujorin e parë të 2009-tës inflacioni bie me 0.5 përqind.




Fig. 5. Inflacioni sipas tremujorëve për periudhën 2007-2009.
Fig. 5. The inflation rate for 2007-2009 years.

Depozitat. Ka një ngadalësim të ritmeve të rritjes së depozitave, gjë që prek bilancin e bankave tregtare, por jo aftësinë paguese të tij.

Treguesi i parësë jashtë bankave për monedhën vëndase shënoi rritje të

shpejtë, pasojë e pasigurisë së publikut për të depozituar në banka.

Në vijim paraqiten pamja grafike e treguesve të lartpërmëndur




Fig. 6. Rritja e depozitave për periudhën 2007-2009
Fig. 6. The increase of the deposits for 2007-2009 years..




Fig. 7. Paraja jashte bankave 2008-2009
Fig.7. The circulation money for 2008-2009 years.

Rritje e kërkesës së qeverisë për hua. Për arsye të mungesës së likuiditeve, rritet kërkesa e qeverisë për të marrë huan nga publiku. Pasoja është rritja e normave të interesit të letrave me vlerë të qeverisë.

Kështu në mars të 2009 –tës norma e interesit të bonove të thesarit është në nivelin më të lartë 9.2 përqind.




Fig. 8. Norma e interesit për bonot e thesarit..
Fig. 8. The interest rate of the treasury bills.

Tkurria e kredisë për ekonominë. Eshte nga simptomat më të rënda te krizës financiare botërore. Për shumë ekonomi të zhvilluara kanali ndërbankar i kreditimit të ekonomise ka qënë pothuaj inekzistent.

Norma vjetore e rritjes së portofolit të kredisë në muajin shkurt 2009-të u ngadalësua në 28.5 përqind krahasuar me 44.2 përqind në muajin tetor 2008 -të.




Fig. 9. Ecuria e teprices së kredisë për 2009-te.
Fig.9. The trend of the credit outs tanding for 2009 year.

2.2 Ndikimi i krizës në ekonominë reale

Kriza ka ndikuar jo vetëm në treguesit financiarë, por dhe në treguesit ekonomikë. Megjithatë, ekonomia shqiptare jo vetëm nuk u perfshi ne recension, por dhe ruajti ritme të rritjes ekonomike.

Kjo shpjegohet me disa faktorë.

Përmasat dhe struktura e ekonomisë tonë bëjnë që ekonomia të jetë më pak e prekshme nga luhatjet e ekonomisë botërore.

Struktura e PBB-së, përbëhet kryesisht nga shërbime, afro 60 përqind, dhe nga produktet bujqësore afro 19 përqind.

Të dyja këto janë më pak të prekshme nga kriza botërore.

Prodhimi industrial përbën 8 përqind të PBB-se përbëhet nga:

-Prodhimi i energjisë, që varet vetëm nga kushtet natyrore.

-Prodhimi i disa mineraleve për eksport .

-Prodhimi i veshmbathjeve (me material të porositësit) që kryesisht eksportohen.

Pra, vështirësitë e eksportit të mineraleve, për arsye të uljes së cmimeve dhe vështirësitë e eksportit të produkteve të industrisë tekstile kanë ndikuar negativisht në rritjen ekonomike.

Të ardhurat nga emigrantët janë një burim rëndësishëm i ekonomisë së vendit. Ulja e tyre ndikon në:

-Fuqinë blerëse të popullatës së vendit.

-Në kursin e monedhës tonë me valutat e tjera.

-Investimet e mundshme të emigrantëve në vendin tonë.

Për arsye të uljes së bilancit tregtar dhe të remitançave është përkeqësuar treguesi i deficitit të llogarisë korente në raport me PBB-në

Kështu me 31.12.2008 deficit i llogarisë korente është 14.9 përqind të PBB-se kundrejt nivelit 10.4 përqind në një vit më parë.




Fig. 10. Llogaria korente.

Fig.10. The current account.

2.3 Ndikimi i krizes ne bujqesine shqiptare

Mund te thuhet se ndikimi i krizes ne sektorin e bujqesise ka qene me i paket.

Viti 2008 –te, qe eshte viti dominant i krizes financiare, per bujqesine shqiptare ka qene nje vit i mbare.

Keshtu prodhimi i grurit kete vit eshte rritur me 20 përqind. Siperfaqja e mbjelle me miser ishte me larte se vitin e kaluar. Ne vitin 2008-te Shqiperia ka importuar 47 mije ton me pak drithera, buke dhe miell.

Prodhimi i rritur ndjeshem ne perime solli dhe nje ulje te cmimeve ne treg. Siperfaqet e mbjella me foragjere u rriten ne masen 14 përqind. Pemetaria gjithashtu njohu mjaft arritje. Vetem ne pranveren e ketij viti jane mbjelle 860.663 rrenje peme te reja frutore. Por, pavaresisht nga keto arritje ekspertet e FMN-se theksojne se kemi nje

renie prej 1.9 përqind te prodhimit real te ketij sektori. Ekspertet pohojne se pavaresisht rritjes nga viti ne vit i fondeve per kete sektor, eshte e domosdoshme mbeshtetja me me shume projekte dhe subvencione .

Ndersa nga analistet e ekonomise shqiptare

sektori i bujqesise prioritet i zhvillimit te ekonomise shqiptare.

3. Masat për të zbutur efektin e krizës.

3.1 Hartimi i rregulloreve përkatëse.

Në fillim të 2008–tës Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë ka miratuar një paketë masash rregullative me synim stabilitetin financiar të vendit. Kryesisht paketa përmban;

-Kritere të reja për llogaritjen, mbikëqyrjen dhe raportimin e ekspozimeve të mëdha të riskut të bankave tregtare ndaj

bankave mëmë dhe subjekteve të vetëlidhura me të.

- Një rregullore e re për forcimin e kontrollit të brendshëm në bankat dhe degët e bankave të huaja. Kjo përbën një platformë për të krijuar një sistem eficient të kontrollit të brendshëm.

- Rregullore mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare. Standardizohet mënyra dhe forma e dhënies së informacionit për klientët lidhur me produktet dhe shërbimet bankare të ofruara.

Me qëllim diversifikimin e riskut, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, modifikoi rregulloren për administrimin e rrezikut, dhe konkretisht;

- Në vendosjen e kufijve më të arsyeshëm të treguesve të ekspozimeve të mëdha

- Në teknikat e llogaritjes dhe njohjes së kolateralit.

3.2 Përdorimi i instrumentave monetarë dhe fiskalë.

3.2 Use of monetary and fiscal instruments.

Në janar 2009-ës niveli i normës bazë të interesit ulet në 5.75 për qind nga 6.75 për qind. Synimi është:

-Uja e kostos së huamarrjes së bankave, lehtësimi i kreditimit të ekonomisë.

-Konsolidimi i mëtejshëm i stabilitetit financiar të sistemit.




Fig. 11. Norma bazë e interesit të Bankës së Shqipërisë

Fig. 11. The interest rate of Albanian Bank..

Politika fiskale nëpërmjet kufizimit të deficitit buxhetor në nivele të pranueshme, ka kontribuar në ruajtjen e balancave makroekonomikë.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Kriza globale ka si shkak themelor disbalancën ndërmjet burimeve, konsumit dhe kursimit të ekonomisë.

Tiparet e ekonomisë së vendit tonë kanë amortizuar në një masë të konsiderueshme efektin e krizës globale.

Kriza globale ka prekur treguesit kryesorë makroekonomikë të vendit, por pa shkaktuar recension, si dhe pa aftësi likuiduese të sistemit bankar dhe financiar.

Masat perkatëse të marra nga Banka e Shqipërisë dhe qeveria në përgjithësi kanë rezultuar të efektshme.

Kriza rigjallëroi debatin ekonomik mbi ndërhyrjen e shtetit në ekonomi. Kapërcimi i krizës do të arrihet përmes një kombinimi të recetave kejniane me teorinë neoliberales.

REFERENCAT

BANKA E SHQIPERISE.(2008) “Raport statistikor”.Tirane.

BANKA E SHQIPERISE (2008), “Raport i Mbikëqyrjes së Sistemit Bankar”.

INSTAT.(2008). Statistika

PANO, A (4 Prill 2009) Kriza e tanishme financiare-kreditore dhe ndikimi i saj në ekonominë tonë., fq, 2-6

MARGARET,A(2009).,“Shqipëria një rast suksesi?” Interviste faqe,1-2.